



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. _____ Prot

Maliq, më 23. 02. 2024

PROJEKT-VENDIM - Nr. 11

Për

Një ndryshim mbi Projekt-Vendimin nr.34 datë 30.03.2022 “Për Krijimin e Këshillit Vendor Rinor dhe miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij”.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64 “Kompetencat e Kryetarit të Bashkisë”, gërma (c), Neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, gërma (k), Ligjit nr.75/2019 “Për rininë” neni 7, pika 1, gërma “b”, neni 10, pika 3, VKM-së Nr. 681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”,

PROPOZOJMË:

1. Të bëhet një ndryshim në “Kriteret dhe procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit vendor rinor si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tij”, si më poshtë.
2. Në pikën 3 të bëhet ndryshimi nga 6 anëtarë në 10 anëtarë dhe ne pikën 4 përbërja të ndyshohet si më poshtë:
 - KVR do te ketë në përbërje:
 - a) Kryetari i Bashkisë, Kryetar.
 - b) Përfaqësues i administratës nga sektori i rinisë (anëtarë).
 - c) Përfaqësues nga organizatat rinore ose organizatat për të rinjtë (anëtarë).
 - d) Përfaqësues nga të rinj aktiv të Njësisë Administrative (anëtarë).
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Sektori i Rekreacionit, Turizmit dhe Rinisë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

Konceptoi : J. Thomo

Drejtor i Drejtorisë : G. Floqi

Dt. 23/02/2024

Dt. 23/02/2024

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
KRYETARI**

Maliq, më 23 . 02 .2024

LËNDA: Relacion mbi Projekt-Vendimin nr.34 datë 30.03.2022 “Për Krijimin e Këshillit Vendor Rinor dhe miratimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij”.

Drejtuar : Këshillit të Bashkisë Maliq

Të nderuar këshilltarë,

Projekt-Vendimi nr.34 datë 30.03.2022 “Për Krijimin e Këshillit Vendor Rinor dhe miratimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij”, mbështetet në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64 “Kompetencat e Kryetarit të Bashkisë”, gërma (c), Neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, gërma (k), Ligjit nr.75/2019 “Për rininë” neni 7, pika 1, gërma “b”, neni 10, pika 3, VKM-së Nr. 681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”.

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor dhe ne si bashki kemi krijuar Këshillin Vendor Rinor (KVR) në Bashkinë Maliq, i cili do përbëhet nga 6 (gjashhtë) anëtarë. Sipas dizpozitave ligjore kryetar i këtij këshilli vendor është kryetari i bashkisë.

Bashkë me miratimin për krijimin e Këshillit Vendor Rinor, duhet të miratohen gjithashtu dhe kriteret dhe procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tij.

Për sa më sipër me anë të këtij Projekt-Vendimi i kërkojmë Këshillit të Bashkisë ndryshimin e pikës 3 dhe 4 të “Kritereve dhe procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit vendor rinor si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tij” si më poshtë,
Në pikën 3 të bëhet ndryshimi nga 6 anëtarë në 10 anëtarë dhe ne pikën 4 përbërja të ndryshohet si më poshtë:

KVR do te ketë në përbërje:

- Kryetari i Bashkisë, Kryetar.
- Përfaqësues i administratës nga sektori i rinisë (anëtarë).
- Përfaqësues nga organizatat rinore ose organizatat për të rinjtë (anëtarë).
- Përfaqësues nga të rinj aktiv të Njësisë Administrative (anëtarë).

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

Konceptoi : J. Thomo

Drejtor i Drejtorisë : G. Floqi

Dt. 23.02/2024

Dt. 23.02/2024

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU